

VARIETETET E REJA TË MOLLËS 2012

Përgatiti: **Dr. Hafuz DOMI**

Redaktoi: **Liljana ISAKAJ**

Dizenjoi: **Ilir Mullaj**

Shtypur në shtypshkronjën "albPAPER"

Copyright © Autori.

Ky liber është mbështetur nga PROMALI dhe është produkt I bashkepunimit me ADAD/FERT

SNV/PROMALI: www.snvworld.al ADAD: www.adadmalore.al,



Tiranë 2012

I nderuar lexues,

Është një kënaqësi për mua që, në emër të SNV/Promali, të prezantojmë për ju një material shumë të dobishëm mbi varietetet e reja të mollës, të sjella në tregun shqiptar me mbështetjen e projektit Promali. Në këtë kuadër, dëshiroj të evidentoj punën profesionale e plot përkushtim, të zhvilluar nga ADAD – Shoqata e Zhvillimit të Rrethëve Malore.

Promali është një projekt i fi nancuar nga Qeveria Daneze dhe SNV-Organizata Hollandeze për Zhvillim, dhe ka për qëllim përmirësimin e nivelit të jetesës së zonave malore të vendit, duke mundësuar zhvillimin e tre sektorëve prioritarë për zonat malore dhe konkretisht sektorit të frutave, bagëtime të imta dhe bimëve medicinale. Sektori i frutave është përfshirë në projektin Promali për dy arsye themelore: së pari, sepse frutat përfaqësojnë një burim

të rëndësishëm për punësimin dhe të ardhurat për zonat malore dhe së dyti, sepse sektori ka një potencial të lartë për zëvendësimin e importeve. Të dhënat e fundit nga sektori i frutave, tregojnë se zgjedhja strategjike e bërë nga projekti Promali ka qenë e drejtë: pesha

e importeve të mollës në ofertën e vendit ka rënë në mënyrë të ndjeshme. Ne sot importojmë vetëm 11,000 ton mollë nga 38,000 ton që importonim vetëm pak vite më parë. Nga ana tjetër, ne kemi fi lluar të eksportojmë mollë në rajon e më gjerë. Rezultatet dëshmojnë drejtësinë e politikës së qeverisë për mbështetjen e sektorit të frutave, por ato janë gjithashtu edhe dëshmi e kontributit të Projektit Promali në këtë sektor. Promali ka realizuar disa ndërhyrje inovative që kanë rezultuar në modernizimin e sektorit të prodhimit të mollës në Shqipëri. Disa nga ndërhyrjet e projektit janë: sjellja për herë të parë në tregun shqiptar e 35 varieteteve të reja të mollës, krijimi i një qendre prognoze-sinjalizimi për mbrojtjen e bimëve, demonstrimin e pajisjeve të thjeshta të ushqyerit të bimëve, nxitjen e veprimit kolektiv në sigurimin e shërbimeve bujqësore, mbështetjen me investime në teknologjinë e pas-vjeljes, mbështetjen e industrisë së përpunimit të frutave dhe krijimin e markës së parë rajonale të mollës, "Molla Korça". Sjellja në tregun shqiptar e 35 varieteteve të reja të mollës, pritet të rezultojë në efekte pozitive afat-gjata sepse: *së pari*, varietetet e reja do të bëjnë të mundur uljen e mëtejshme të importeve, varietetet e reja prodhojnë fruta më cilësore dhe që mund të ruhen më gjatë në frigorifer; *së dyti*, varietetet e reja do të bëjnë të mundur diversifi kimin e prodhimit e të konsumit të mollës. Rezistenca e disa varieteteve

ndaj sëmundjeve, do të bëjë të mundur prodhimin organik. Nga ana tjetër, disa varietete janë të përshtatshme për gatim dhe pra do të ndikojnë në diversifi kimin e konsumit; *së treti*, varietete e reja do të përmirësojnë pozicionin konkurrues në tregjet e eksporteve – kjo për shkak të shijes, pamjes dhe qëndrueshmërisë së frutave të varieteteve të reja. Gjithë sa thashë më sipër do të bëhet e mundur vetëm nëse varietetet e reja njihen, promovohen dhe në fund të fundit kultivohen nga fermerët. Publikimi mbi cilësitë e varieteteve të reja të mollës -tashmë i disponueshëm për secilin prej nesh – është një guidë e mirë që i shërben njohjes dhe promovimit, por edhe orientimit të fermerëve lidhur me varietetin e përshtatshëm që ata duhet të mbjellin në vartësi me objektivat e biznesit të tyre.

Elvana ZHEZHA
Drejtoreshë Ekzekutive

[SNV-Organizata Hollandeze për Zhvillim në Shqipëri](#)

1. HYRJA

Pas viteve 2000 specia e mollës mori një zhvillim të madh, jo vetëm në arealin e saj të njohur në veri-lindje, por dhe në zonën e ulët të vendit tonë. Pemëtoret ekzituese u zëvendësuan me të reja, molla po kultivohej në toka të rrafështa dhe pjellore, filloj kultivimi intensiv i saj dhe u futën teknologji të reja. Por pavarësisht nga ky zhvillim, kishte dhe një problematikë që rrishte për të ardhmen, që ishte mungesa e fidanëve cilësorë dhe të varieteteve të reja, për shkak të mungesës të Pemëtores Mëmë për fidanishtet. Pikërisht në këtë kontekst SNV/Promali mori përsipër që ta zgjidh këtë problem dhe për ta vënë në baza të shëndosha kultivimin e mollës për të ardhmen. Për këtë bashkëpunoj me ADAD / FERT dhe i mobilizoj për projektin e fidanishtes në Zëmlak të Korçës, të cilët kanë dhënë më parë një kontribut të vecantë, kryesisht në rajonet Korçë, Dibër dhe Kukës, ku kanë vënë bazat e kultivimit intensiv, kanë futur bazën gjenetike për prodhimin e fidanve të shoqëruar me teknologjinë e re. Ky kontribut është shtuar në vazhdim nga SNV Promali, ku sot kemi një bazë të gjerë gjenetike dhe kapacitete të mëdha për plotësimin e nevojave për fidanë molle për gjithë vendin dhe më gjerë.

Fidanishtja Zëmlak është fidanishtja kryesore në vend për prodhimin e fidanëve të mollës. Ajo sot disponon bazën gjenetike të 8 varieteve të nënshartësve vegjetative dhe të 50 varieteve të mollës, nga ku 35 varietete janë të reja. Kjo bazë gjenetike është sjellja nga Franca përkatësisht në vitet 2004 dhe 2011-2012, e cila përbën koleksionin më të madh të mollës në vendin tonë për prodhimin e fidanëve të mollës dhe kryesisht për pemëtores intensive. Ky koleksion është më i madhi pas vitit 1990 dhe i treti në kohë, pas atyre të viteve 1972 dhe 1982.

Kjo brushurë është fruti i bashkëpunimit të SNV/Promali dhe ADAD/FERT dhe i një pune trevjecare që është realizuar në Pemëtoren Mëmë në Zëmlak të rajonit të Korçës.

Ky libër do të jetë një manual në duart e fermerëve dhe specialistëve dhe do tu shërbej si udhërrëfyes për ngritjen e pemëtoreve cilësore dhe rentabël. Me këtë libër do orientohen dhe do të dinë të :

- Zgjedhin cilësinë e fidanit dhe mbjelljen e fidanëve dy vjecar si tendencë e së ardhmes
- Zgjedhjen e varieteteve të reja në përshtatje me tokën dhe klimën.
- Përcaktimin e formës së kurorës dhe dendësisë e mbjelljes
- Kombinimin e varieteteve që në mbjellje për polenizim dhe prodhim të qëndrueshëm
- Zgjedhjen e varieteteve sipas periudhës së pjekjes dhe kohëruajtjes
- Zgjedhjen e varieteteve të qëndrueshmëm nga kromës
- Zgjedhjen e varietetit për prodhim "BIO"

Të gjitha këto zgjedhje do ta gjejnë përgjigjen në këtë libër dhe do tu jap efektivitet në punën si pemëtarë, njëkohësisht do tu shërbejë për ngritjen e pemëtoreve intensive dhe "bio" dhe sigurisht do të jeni konkurentë në tregun global në të ardhmen. Gjithashtu, ju duke mbjellë varietetete të reja pa shmangur dhe ato tradicional dhe të vendit, shpresoj që në të ardhmen duke pasur në treg dhe varietete të reja do të evolojë dhe shija e konsumatorit shqiptar.

Ju urojmë lexim të këndëshëm